

Data di pubblicazione: 30 giugno 2021

DASHNOR DERVISHI, *50 vjet marredhenie me jashte*, ISBN: 9789928084439, Publisher Mediaprint, Tirane 2020.

In his first book of the series “50 Years of Foreign Relations”, Ambassador Dashnor Dervishi covers his experience encompassing the period 1972-1992

The events and observations depicted in the book highlight the fact that despite the social system and the interests of the political class in power, the strategic interests of the country remain the fundamentals of its foreign policy.

The relations of the Party-State with the leftist movements in Latin America during 1970-80 were driven by the power that had its influence in Albania at that period. Aware of its actions, the political leadership followed the conjunctures for the preservation of power, thus ensuring vital aid for the finances and economy of the country, as well as the international support of conjectural alliances.

Most of the book comprises the memoirs of the Ambassador in Italy, in the period 1988-1992. It was a time, when right after the fall of the Berlin Wall, the demarcation line between the two blocs during the Cold War, was displaced from the Adriatic Sea to the Black Sea and Albania became part of the social system it belonged to. Under the new circumstances, the political rapport between Italy and Albania assumed a more “geographic

dimension” and Rome became the main point of reference for all the relations with the West. Italy became the “promised land” of the Albanians, making a reality of the expression “All roads lead to Rome”. The departure of Popa family to Italy, after a 5-year long refuge in the Italian embassy (1985-1990), was followed by mass inundation of the embassies in Tirana, a biblical departure of more than 25 thousand Albanians towards the Italian shores, on 13 July of the same year.

The first “secret” meetings with religious and lay representatives, enabled the visit of Saint Tereza of Calcutta in Albania and the establishment of diplomatic relations with the Holy See. This period in Italy was characterized by the intensification of unprecedented relations between Albania and Italy in all fields.

After 22 March 1992, the democratic system was established in Albania. Under the new conditions, the role and the position of Albania in the European and Regional arena did not change and the non-productive idea of the country’s leadership that the West and the US need us, fueled the old mentality: “We govern and the world helps us”.

Dashnor Dervishi

Reflektime të mëtejshme të autorit

DASHNOR DERVISHI

50 Vjet Marrëdhënie me Jashtë është libri me autor ambasador Dashnor Dervishi. Libri është shkruar duke u bazuar në shënimet e mbajtura gjatë veprimtarisë në shërbimin e jashtëm, në informacionet dhe analizat zyrtare të hartuara për MPJ nga pozitat e ambasadorit, si dhe në kujtesën dhe përshtypjet e tij të kohës.

Në 50 vjet shërbim në marrëdhëniet me jashtë, 20 vitet e para, që trajtohen në këtë libër, i përkasin periudhës deri në vitin 1992, të ndara në disa etapa kohore. Sipas kapitujve, shënimet shoqërohen me fotografi dhe dokumenta origjinale të kohës.

Ngjarjet dhe reflektimet që dalin nga botimi i pjesës së parë, nxjerrin në pah se pavarësisht sistemit shoqëror dhe interesave të klasës politike në pushtet, parimet bazë të interesave strategjike të vendit mbeten gjithmonë të njëjtat në themelet e politikës së jashtme të çdo vendi.

Shënimet fillojnë me përshtypjet gjatë kontakteve të para me të huajt, që kanë shënuar në ndërgjegjen dhe formimin e autorit gjurmë të pashlyeshme, duke e ndjekur në çdo hap të punës së mëvonshme në shërbimin si diplomat. Ato tingëllojnë aktuale edhe sot.

Jo më kot rrugëtimi drejt botës së huaj jashtë kufijve të Shqipërisë fillon me përshkrimin e disa episodeve ngjarjeve “naive” gjatë kontakteve me të huajt, për të arritur në episode krejt të ngjashme në thelb, pavarësisht se

janë zhvilluar në kohë të tjera dhe më vonë në nivele të larta përfaqësimi shtetëror.

Ura e Bushtricës, jo më kot ka zënë kopertinën e librit; sepse aty, mbi këmbët e Urës dhe trasesë së hekurudhës që u rritën bashkë me brezin e diplomatit të ardhshëm, ai mori trenin për t'u futur në botën e pafundme dhe me shumë të panjohura jashtë kufijve të Shqipërisë. “Në atë kohë, thotë Dervishi, edhe unë ashtu si shumë të tjerë, ishim të bindur se ajo ishte Ura më e madhe në Rajon e më tej, dhe kushdo nga miqtë e huaj që e vizitonin, mburrjet e mia i duartrokisnin me lëvdata”.

“U ndjeva për herë të parë i zhgënjyer në udhëtimin e parë jashtë vendit, kur pashë urat me përmasa gjigande, gjë që më ndihmoi për të mos e përsëritur më gabimin me mburrjet në bisedat me të huajt, gjatë karrierës së mëvonshme diplomatike”.

Periudha e dytë, i përket veprimtarisë në ndjekje të zhvillimeve në Amerikën Latine dhe të marrëdhënieve të Partisë Shtet me vendet e atij kontinenti, kryesisht të lëvizjeve të majta, kur Dervishi ishte fillimisht specialist e më vonë përfaqësuesi më i lartë i shtetit shqiptar pranë qeverive të disa prej atyre vendeve latino- amerikane.

Në punën me Amerikën Latine, ndjekja nga afër e lëvizjeve të majta të asaj kohe dhe roli i vendit tonë nëpërmjet marrëdhënieve që Partia Shtet kishte vendosur me to, krijuan ndjesinë se sa më i vogël dhe i varfër të jetë një vend si rasti i Shqipërisë, aq më shumë pushtetarët e tij krijojnë raporte në përpjestim të zhdrejtë midis marrëdhënieve me të huajt nga njëra anë dhe popullit të tyre nga ana tjetër, duke u deformuar në paranojakë me të parët dhe në arrogantë me të dytët.

Duke qenë një vend i vogël, Shqipëria asnjëherë nuk ka arritur të luajë ndonjë rol të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Sipas konjunkturave të kohës, udhëheqja e vendit është vënë në shërbim të asaj fuqie të madhe që ka pasur më shumë ndikim në Shqipëri, ndikim që e krijonte udhëheqja, sipas interesave të saja. Kështu ndodhi gjatë ndikimit jugosllav, po ashtu gjatë marrëdhënieve me kampin sovjetik, gjë që vazhdoi me lidhjet dhe praninë e ndikimeve kineze. E ndërgjegjshme për veprimet e saja, udhëheqja politike shfrytëzonte konjunkturën për ruajtjen e pushtetit, me propagandën brenda vendit se kishte mbështetje ndërkombëtare, duke siguruar kështu ndihma jetike për financat dhe ekonominë e vendit, si dhe mbështetje ndërkombëtare nga aleancat konjunkturale të kohës.

Pavarësisht shkaqeve ideologjike që propagandoheshin për opinion publik, shkaqet e vërteta të prishjes së PPSH-së, si me Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe me Kinën, kishin në bazën e tyre kundërshtitë në lidhje me kushtëzimin e ndihmave për vendin me kërkesat për qëndrime më liberale, por edhe sugjerimet konkrete preferenciale për ndryshime në lidhshimin e vendit, si dhe për ndryshime të qëndrimeve tona në marrëdhëniet me Jugosllavinë.

Në marrëdhëniet me vendet fqinje, vëmendja e partisë-shtet ishte përqendruar në marrëdhëniet ndërshtetërore, pavarësisht propagandës që bëhej kundër ideologjisë “monarko-fashiste” greke apo kundër regjimeve ushtarake në Turqi. Edhe në këto vende kishte grupe e individë të veçantë që mbështesnin politikën e Partisë së Punës dhe kërkonin të viheshin në kontakt me të. Por Drejtoria Jashtme tregonte një kujdes të veçantë në qëndrimin ndaj tyre. Ndërkohë, gjendej mënyra për të siguruar përkrahjen,

duke u përpjekur për të mos krijuar asnjëherë marrëdhënie të qëndrueshme me ta.

Dekada e viteve 1980 ishte periudha e ndryshimeve të rëndësishme cilësore, që u shoqërua me ngjarje të mëdha në të gjithë botën, por në mënyrë të veçantë në Evropë, që si gjithmonë mbetet laborator i përpunimit të mendimit dhe organizimit social. E njëjta gjë ndjehej edhe në kontinentin latino-amerikan, ku vendin e juntave ushtarake apo diktatoriale, po e zinin gjithnjë e më shumë regjimet demokratike.

Në fund të vitit 1986 diskutohej për emrin e ambasadorit të ri, që do të shkonte në Meksikë. Mbas disa peripecish, u përfundua tek kandidatura e Dashnor Dervishit.

Ambasada e Meksikës mbulonte edhe 6 vende të tjera, me të cilat Shqipëria kishte marrëdhënie diplomatike: Ekuadori, Kolumbia, Venezuela, Nikaragua, Kosta Rika dhe Panamaja.

Periudha e tretë i përket Italisë; pavarësisht kohës së qëndrimit prej katër vitesh, kapitujt e Italisë zënë periudhën më voluminoze, për vetë zhvillimet intensive që ndodhën në atë kohë. Periudha nga viti 1988 deri më 1992 përfshin vitet e ndryshimeve të mëdha jo vetëm në Evropë por dhe në Shqipëri.

Në ato vite transformimesh të thella në botë dhe në Shqipëri, Roma u kthye në qendrën kryesore të referimit të të gjithë spektrit shoqëror, ekonomik dhe politik të shqiptarëve, në marrëdhëniet me jashtë vendit. Italia u kthye në qendrën kryesore të kontaktit të vendit tonë me Perëndimin, duke e identifikuar atë me Botën Perëndimore në përgjithësi. Italia u kthye në “Tokën e Premtuar” të shqiptarëve. Më shumë se çdo

herë tjetër, në atë periudhë u bë reale shprehja se “Të gjitha rrugët të shpien në Romë”.

Periudha prej katër vitesh e qëndrimit në Itali, do të kthehej në sprovën më të vështirë dhe më të rëndësishme të veprimtarisë diplomatike të ambasador Dervishit. Gjatë asaj periudhe u desh përballja me ngjarje nga më komplekset, duke qenë jo vetëm dëshmitar i ngjarjeve që ishin jashtë praktikave standarde të diplomacisë së atëhershme të vendit të izoluar ballkanik, por që do të duhej të merreshin edhe vendime të rëndësishme, duke u bazuar thjesht në intuitën njerzore për probleme tepër delikate politike, siç ishin iniciativat “e tepruara” në fushën e kulturës me shfaqjen e bujshme të Albano e Rominës në stadiumin e Tiranës, nxitjen dhe realizimin e vizitës në Shqipëri të nobelisten shqiptare të asaj kohe, Nënë Terezës, etj.

Ishte fundi i viteve 80, koha e ndryshimeve të mëdha politike në botë, kur Luftës së Ftohtë po i vinte fundi. Ishte koha kur Evropa po përgatitej të shënjojte kufij të rinj dhe kur bota do të ridimensiononte aleancat Lindje-Perëndim dhe interesat gjeostrategjike.

Gorbaçovi kishte shpallur reformat ekonomike, nëpërmjet Perestrojkës dhe hapjen nëpërmjet Gllasnostit, duke rritur liritë dhe transparencën dhe duke ulur tensionin ndërmjet dy superfuqive.

Papa Vojtilas përshëndeti rënien e Murrin të Berlinit duke bërë thirrjen e famshme se njerëzimi mbetet gjithnjë në vazhdim të kërkimit për perfeksionimin e shoqërisë së tij.

Në mënyrë të natyrshme, mënyra e drejtimit nën autoritetin e udhëheqësve të vjetër e historikë, që kishin dalë nga Lufta e Dytë Botërore apo që ishin

ende nën ndikimin e saj, po i linte vendin administrimit të pushtetit me qeverisje kolektive, me sistem rotativ e me transparencë më të madhe. Sistemi socialist i Lindjes, i bazuar mbi pronën e përbashkët dhe luftën e klasave, kishte dështuar në garën me Perëndimin, që kishte shfaqur superioritetin e tij gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Në kampin socialist kishin filluar tendencat e shkëputjes, ndërsa Bashkimi Sovjetik po jepte shenjat e shpërbërjes. Në vendet e Lindjes kishin filluar lëvizjet e para për ndryshime dhe krijoheshin gjithnjë e më shumë hapësira për rregjime më të buta e tolerante.

Vija e ndarjes midis dy blloqeve politike e ushtarake gjatë luftës së ftohtë të para viteve '90, u zhvendos nga Adriatiku në Detin e Zi, dhe vendi ynë, për herë të parë në historinë e vet, u gjend gjeografikisht në brendësi të bllokut politik, ushtarak dhe të sistemit shoqëror, në të cilin natyrshëm i takonte të ishte. Ndryshimet e nevojshme që ndodhën në vendin tonë, sollën kalimin e sistemit tonë shoqëror nga ai totalitar në atë demokratik. Shenjat e para të ndryshimeve po shfaqeshin edhe në Shqipëri; ndërkohë që blloqet dhe situatat gjeostrategjike ndryshonin, interesat kombëtare mbeten po ato.

Në vitet 80, gjatë periudhës së luftës së ftohtë, edhe vetë Italia u përfshi në zhvillime të rëndësishme politike. Ngritja e strukturave paramilitare të së djathtës, të njohura me emërtimin "Gladio", rrëmbimi dhe vrasja e Aldo Moros dhe historitë me "Brigadat e Kuqe", ia kishin lënë vendin kompromiseve të mëdha historike, duke krijuar për herë të parë në historinë e Italisë një koalicion qeverisës midis demokristianëve të djathtë të Arnaldo Forlani-t dhe Giulio Andreotti-t me socialistët e majtë të

Bettino Craxi-t. Në Italinë demokratike po fillonin të frynin erërat e reformave akoma më të thella, që do të parapriheshin nga furtuna “Mani Pulite” e prokurorit Antonio Di Pietro.

Ndërkohë vazhdonte paqëndrueshmëria e qeverive italiane, që zëvendësonin pareshtur njëra-tjetrën, duke e vështirësuar ndjekjen e jetës së brendshme politike. Në rrethin diplomatik në atë kohë qarkullonte historia me presidentin amerikan George Bush, i cili, gjatë ditëve të vizitës së tij në Itali, përjetoi ndryshimin e qeverisë. Habisë së tij sesi ka mundësi që të ndodhnin këto ndryshime kaq të shpeshta në Itali, Craxi iu përgjigj se “po të dinim arsyet, nuk do të na ndodhnin”.

Mbas rënies së Murit të Berlinit, politika e jashtme italiane në drejtim të Shqipërisë zinte një vend të veçantë, duke mbetur një “dimension gjeografik” i përhershëm.

Përgjatë viteve 1990-1991, gjithmonë me miratimin e aleatëve të saj evropianë dhe të SHBA-ve, Italia mori përsipër të luante edhe një rol mbikëqyrës ndaj zhvillimeve në Shqipëri dhe Kosovë, si një element i rëndësishëm i faktorit shqiptar në rajon, në kuadër të proceseve shpërbërëse në Jugosllavi. Roli mbështetës i Italisë ndaj vendit tonë, për të kontribuar në stabilizimin e gjendjes ekonomike dhe politike, për të ndihmuar në proceset demokratizuese dhe në ato të hapjes ndaj Perëndimit në mënyrë graduale, nuk mund të mos ndikohej nga faktorët që lidheshin me zhvillimet në Jugosllavi.

Ndërsa në skemat perëndimore ishte skicuar pak a shumë ndarja e ish-republikave të Federatës Jugosllave, ende nuk ishte e qartë e ardhmja e Kosovës, që me statusin e saj si Krahinë Autonome, mund të shpërthente

e të dilte jashtë kontrollit, për shkak të lëvizjeve të para të shqiptarëve në Kosovë, që në fakt ishin fillesat e shpërbërjes së Federatës Jugosllave.

Ambasada shqiptare në Romë ndiqte me kujdes çdo lëvizje, duke marrë takime me përfaqësuesit kosovarë që vinin në Itali, pa u ekspozuar hapur në mbështetjen aktive ndaj çështjes së Kosovës, pasi në atë kohë kjo gjë konsiderohej si ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë. Përveç kësaj, një nga temat më të preferuara të propagandës antikosovare ishte destabilizimi i rajonit nga rreziku i “Shqipërisë së Madhe”. Në ato kushte, ndërmerreshin takime “të fshehta”, duke u kujdesur të mos provokohej ndonjë incident i rastit.

Zhvillimet në Shqipëri dhe ngjarjet në vende të ndryshme të Evropës Lindore ndiqnin njëra-tjetrën. Më 25 dhjetor 1989, në Bukuresht ndodhi përmbysja e përgjakshme e regjimit, dhe ekzekutimi i çiftit Çausheku u shfaq në televizion. Por ngjarjet që po ndryshonin Evropën, kishin trokitur shumë më herët në Shqipëri se në vendet e tjera të Lindjes. Në Ambasadën Italiane në Tiranë, që prej 12 dhjetorit 1985, kishin mbetur të ngujuar gjashtë pjesëtarët e familjes Popa dhe nuk kishte asnjë shenjë për zhbllokim të gjendjes. Me sa duket, ajo që nisi në Shqipëri ia la vendin ndryshimeve të dhimbshme në Rumani, ndërsa ndryshimet në Shqipëri do të kryheshin butësisht, vetëm me histori ambasadash.

Strehimi në ambasadën italiane i gjashtë shtetasve shqiptarë të familjes Popa, nga dhjetori i vitit 1985 deri në maj të vitit 1990, bëri që marrëdhëniet dypalëshe, të cilat po merrnin një farë zhvillimi, të frenoheshin në mënyrë të dukshme. Në pamje të jashtme, të dyja palët e trajtuan ngjarjen me një delikatesë shembullore, duke e konsideruar secila

veten si viktimë të diçkaje që dilte mbi mundësitë e saj për të zhbllokuar gjendjen e krijuar. Pavarësisht gjëndjes së marrëdhënieve pothuajse të ngrira, bëheshin përpjekje artificiale për ta injoruar atë, duke shpresuar në zgjidhjen nëpërmjet “lodhjes”.

Largimi i familjes Popa për në Itali në maj 1990, do të pasohej nga dyndja masive nëpër ambasada më 13 korrik të po atij viti dhe do të përfundonte me largimin në mënyrë spektakolare të më shumë se 5.500 qytetarëve me gjashtë anije drejt brigjeve të Italisë.

Në analizat që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen herë pas here në raste përkujtimore mbi proceset demokratike në Shqipëri, zanafilla përqendrohet në kalimet masive të mureve të ambasadave në Tiranë, si veprimi i parë i shpërthimit të dëshirës së shqiptarëve për liri e demokraci, që do t’u hapte rrugën të gjitha proceseve të mëtejshme, që sollën përfundimisht ardhjen në pushtet të një regjimi demokratik, më 22 mars të vitit 1992. Shkëndija e parë, sakrifica e gjashtë anëtarëve të familjes Popa, u la në harresë.

Puna me bashkatdhetarët dhe shtetasit shqiptarë është një nga detyrat e përhershme të një përfaqësie jashtë vendit; por ndryshe nga sot, përpara vitit 1992, kjo detyrë konceptohej krejt ndryshe dhe ishte mjaft komplekse, ndryshe nga ato që shkruhen për historitë e mërgatave shqiptare të pasluftës, me të arratisur e diversantë.

Në Itali, ambassador Dervishi pati rastin të njihet nga afër me ato dukuri, jo drejtpërsëdrejti, pasi ato ishin shuar në fund të viteve ‘50, por me pasojat e tyre. Aty ai krijoi bindjen se historia me diversantë e sigurimsa ishte një lojë e madhe, që luhej në kurriz të atyre që kishin lënë vendin, me shpresën

se do të merrnin pushtetin me grupe diversantësh dhe me mbështetjen e vendeve të Perëndimit, ku ata ishin strehuar, në një kohë që Jalta kishte përcaktuar kufijtë e të dy sistemeve të ndryshme ideologjike dhe të shteteve të tyre përkatëse. Përmbysja e regjimit komunist të Enver Hoxhës do të thoshte edhe ndryshim i kufijve të dy blloqeve, që vazhduan të ekzistonin deri në përfundim të Luftës së Ftohtë, me rënien e Murit të Berlinit.

Mundësia e marrjes së pushtetit me diversantë ishte vetëm fantazi, pasi nuk kishte asnjë kusht logjistik apo mbështetje reale brenda e jashtë vendit. Ndërkohë që në Poloni, Hungari e Çekosllovakia, kishin dështuar përpjekje shumë më serioze dhe në kushte shumë më të favorshme brenda vendit. Pas 12 dhjetorit të vitit 1990, me krijimin e Partisë Demokratike e më pas edhe të partive të tjera politike, pra me shpalljen e sistemit pluralist në vendin tonë, lindi në mënyrë të natyrshme nevoja për vendosjen e lidhjeve dhe marrëdhënieve të tyre me partitë simotra në Itali.

Në fillimet e tyre, të gjitha partitë ishin në kërkim të homologut të vet, duke u nisur kryesisht nga ngjashmëria në emër. Kaloi shumë kohë, derisa partitë tona arritën në përafrimet e nevojshme, për t'u formatuar secila parti sipas standardeve evropiane, por edhe për të mësuar të bashkëjetonin në të njëjtin sistem me partitë kundërshtarë, si pjesë e domosdoshme e strukturës shtetërore në një shoqëri demokratike.

Që me krijimin e partive të para, drejtuesit kryesorë të demokratëve, republikanëve e socialdemokratëve vrapuan në Romë, për të gjetur të ngjashmit e tyre. Në mungesë të kontakteve dhe të njohjeve, por edhe për arsye të vështirësive teknike e financiare, shumica e tyre iu drejtuan

ambasadës shqiptare, ku pa asnjë dallim apo diferencim, gjetën mbështetjen e plotë dhe pa rezerva.

Ambasada në Romë, krahas ndjekjes së problemeve që lidheshin me punën normale të saj, e pa këtë veprimtari si një detyrë parësore, jo me syrin partiak, por si një nga elementet më të rëndësishëm në shërbim të hedhjes së themeleve të shëndosha për sistemin e ri shoqëror e shtetëror, që po ngrihej në Shqipëri. Nga ana tjetër, edhe drejtuesit e partive kryesore italiane, në kontaktet që po vendosnin me partnerët e tyre të rinj dhe ende të panjohur shqiptarë, e dëshironin praninë dhe “rekomandimin” e ambasadës, që si organizëm zyrtar garantonte se kishte të bënte me parti legale dhe serioze.

Në Itali, shkruan Dervishi, vura re se çfarë pozicioni zë vendi ynë në arenën e politikës së jashtme në qëllimet gjeostrategjike të Evropës dhe të Rajonit tonë si dhe rolin tonë në këto hapësira; rol ky që shpesh nuk përputhet me idetë dhe qëndrimet e establishmentit shqiptar i cili ushqen në opinionin e vendit një filozofi dhe mentalitet krejt të kundërt faktorizimi dhe protagonizmi fals, për ta shfrytëzuar këtë gjë thjesht për mbajtjen e pushtetit brenda vendit.

Duke shërbyer kryesisht në vendet fqinje dhe të Rajonit tonë si në Itali, Turqi, Rumani, Greqi, etj, ai nxjerr konkluzionin se fuqitë e mëdha, si në Perëndim edhe në Lindje, marrëdhëniet e tyre me vendin tonë i kanë ndërtuar prej kohësh mbi bazën e qëndrimeve dhe marrëdhënieve tona kryesisht me vendet fqinje dhe çështjes shqiptare në veçanti.

Qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj të drejtave të minoriteteve, kryesisht atyre me origjinë nga vendet fqinje i kanë ndërthurur këto interesa me vendet

fqinje dhe kanë përcaktuar me kushtëzim edhe aleatët tanë të mëdhenj strategjikë. Kur politika shqiptare do të arrijë të krijojë një raport të drejtë midis këtyre faktorëve, Shqipëria do të kthehet në një vend të sigurtë për investime, pa qenë nevoja që lidershipi politik të mbivlerësojë krijimin e marrëdhënieve apo simpatie personale me udhëheqës të rëndësishëm politikë nëpër botë apo biznesmenë të fuqishëm privatë të huaj.

Me sloganin “Ne qeverisim dhe Bota na ndihmon”, është ushqyer ndër vite mentaliteti i gabuar se Perëndimi dhe Amerika kanë nevojë për ne, prandaj e kanë për detyrë të na ndihmojnë, se ne kemi në dorë stabilitetin e Rajonit e të tjera si këto. Por më e keqja është se kjo gjë ka kultivuar një farë dembelizmi dhe pritshmërie për çdo gjë nga jashtë, duke institucionalizuar ndihmat e huaja në të njëjtin nivel me atë që ne vetë duhet të bëjmë në fushën e ekonomisë apo të reformave sociale e politike brenda vendit. Në dekada, kjo ka sjellë deformimin në opinionin e vendit, duke krijuar përshtypjen e gabuar për t’i matur punën e qeverisë së radhës jo nga reformat apo investimet serioze që realizon, por nga aftësia për të mbledhur e siguruar ndihma nga jashtë.

Gjatë vitit 1991-92, delegacionet e shumta që vinin në Itali nga Shqipëria apo anasjelltas, përcillnin projekte nga më interesantet. Dukej sikur Shqipëria kishte hyrë nën patronazhin e Italisë, në pritje të një Plani Marshall. Ndërkohë, projektet dhe vendimet e marra nga mbledhja e përbashkët e dy qeverive dhe e komisioneve të shumta që arrinin shuma prej dhjetëra miliardë liritash, nuk arritën të konkretizohen.

Në një nga intervistat në shtypin italian ambasador Dervishi do të theksonte se “Për Shqipërinë duhet një plan Marshall. Tërë mund të

kthehej në një laborator të shoqërisë postkomuniste”. Pa mohuar domosdoshmërinë e ndihmave italiane në momente të vështira, ai i përshkruan ato si aspirina që ndihmojnë në uljen e temperaturës... “Në qoftë se gjysma e shumës që u shpenzua për furnizimin me prodhime ushqimore, do të vinte në formën e kredive financiare, gjendja do të ishte më e mirë, si për ekonominë shqiptare, ashtu edhe për të zhvilluar raportet dypalëshe më të forta me Italinë...Në Tiranë nuk duan të dëgjojnë më fjalën “ndihmë”, por duan që ta zëvendësojnë atë me fjalën “bashkëpunim”. Bashkëpunimi është ndihma më e mirë, si për Shqipërinë e sotme, ashtu edhe për raportet dypalëshe për sot dhe për të ardhmen”. Gjatë vitit 1992, marrëdhëniet komplekse midis Italisë dhe Shqipërisë morën një karakter tjetër. Skenat biblike të refugjatëve shqiptarë mbi anijet e rrëmbyera nëpër Adriatik dhe pamjet dramatike në brigjet dhe portet italiane filluan të harrohen, ndërkohë që në Shqipëri po merrte rrugë faza e fundit e zhvillimeve demokratike drejt zgjedhjeve të 22 marsit. Edhe gjendja në Jugosllavi u bë më e qartë me shpërbërjen e saj dhe krijimin e shteteve të reja ballkanike të Sllovenisë dhe Kroacisë në 25 qershor 1991, ndërkohë që Kosova nuk krijoi ndonjë problem në atë fazë. Roli, por edhe interesat ambicioze të Italisë në Ballkan e Shqipëri, filluan të zbehen me rritjen e pranisë së SHBA-ve, Gjermanisë, Vatikanit, etj. Kontaktet me fenë dhe me përfaqësuesit e besimeve të ndryshme fetare në veprimtarinë e Dervishit jashtë vendit pasqyrohen deri diku edhe në këtë libër. Takimet e para “sekrete” me përfaqësues fetarë e laikë, me shoqata e kardinalë të rëndësishëm për kohën, bënë të mundur për të sjellë në Shqipëri një nga figurat më të ndritura të kombit shqiptar, shënjtoren

Nënë Tereza; dhe më tej, hapjen e portave të Vatikanit, gjë që çoi në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me vendin tonë.

Qëlloi që Dervishi të ushtrojë detyrën e ambasadorit në katër nga vendet që përfaqësojnë katër kulturat më të rëndësishme të besimit fetar që kanë ndikuar në botë me filozofinë e tyre ndër shekuj; po ashtu edhe në Shqipëri, përveç sinagogave të judaizmit hebre, ato simbolizohen në qendër të kryeqytetit me tre institucionet e kultit mysulman, ortodoks dhe katolik, ku besimtarët e secilës fe ushtrojnë ritet fetare në ato godina pa dhënë më të voglin kontribut për ngritjen e tyre.

Autori ka krijuar bindjen se besimi në vetvete për të bërë diçka për vehte dhe për Shqipërinë, fillon në praktikimin e riteve fetare në institucionet e kultit, të ndërtuara me kontribut të brendshëm nga komunitetet lokale të çdo feje dhe jo duke u falur në kishat e xhamitë e ngritura nga të tjerë në formë ndihme.

Funksioni i diplomacisë është menaxhimi i marrëdhënieve ndërkombëtare nëpërmjet bisedimeve. Njësoj si fushat e tjera shoqërore, diplomacia është gjithashtu në transformim të përhershëm. Bota diplomatike përballet në mënyrë të vazhdueshme me “të vjetrën” dhe “të renë”. Teoria dhe praktika e diplomacisë kanë nevojë të përballen vazhdimisht me zhvillimet shoqërore dhe t’u përshtaten atyre.

Sidoqoftë, kur mjedisi shoqëror dhe politik bën thirrje për ndryshime, që kapërcejnë “zakonet diplomatike”, duhet pasur kujdes që ndërkohë që ndërmerren ndryshimet e nevojshme, të mos ketë përkeqësim, si në cilësinë e diplomacisë, ashtu edhe në nivelin e arritjes së objektivave që komuniteti pret të përmbushen prej saj.

Në vitet 1990 – 1991 diplomacia shqiptare ishte disa hapa përpara në perceptimin e procesit të ndryshimeve që po ndodhnin, jo vetëm në Evropë, por edhe në Shqipëri. Nga ana tjetër, duhet thënë se edhe në një pjesë të klasës politike shqiptare kishte një perceptim më të përparuar për nevojën e avancimit në marrëdhëniet ndërkombëtare, në raport me nxitjen e reformave demokratike brenda vendit. Diplomatët shqiptarë kishin kohë që kishin dalë jashtë kornizës së rregullave të deriatëhershme. Pa marrë ndonjë porosi direkte, por vetëm me ndjesinë e tyre dhe “lejen” në heshtje të Tiranës, përfaqësuesit në Nju Jork dhe vende të tjera kishin hyrë në kontakte dhe bisedonin pa frikë me përfaqësuesit e vendeve, me të cilët, deri në atë kohë, ishin rreptësisht të ndaluara takimet e bisedat, si SHBA-të, B.S-ja., Britania, Izraeli, Afrika e Jugut, etj.

Dikur ambasadori ishte emblema e shtetit të vet, ishte me të vërtetë ashtu siç shkruhet në dekretin e Presidentit: Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë. Sot, ky rol ka pësuar ndryshime të mëdha. Kjo nuk ndodh vetëm në Shqipëri, është risi për të gjitha vendet në botë. Arsyet dihen: globalizmi, hapja e kufijve, gjithëpërfshirja, integrimi, etj. Dhe është shumë mirë. Sipas ambasadorit Dervishi “Dikur, në objektivat tona, kjo gjë ishte një nga synimet kryesore: hapja, shtimi i kontakteve, komunikimi i drejtpërdrejtë. Kjo nuk e ul aspak rolin dhe rëndësinë e ambasadorit, përkundrazi, i jep më shumë rëndësi, dhe e bën në të njëjtën kohë edhe më të vështirë punën e tij; kërkon më shumë pasion, përkushtim, cilësi dhe vizion, sepse dinamikat kanë shpejtësi marramendëse, gara është bërë më e fortë, pasi tani të gjithë merren me politikën e jashtme, si gjysma e popullsisë që ndodhet jashtë, ashtu edhe ajo që ka mbetur brenda vendit.

Tani, gjithnjë e më shumë, po promovohen ambasadorët e nderit, ku përfshihen personalitete të fushës së letrave, të artit apo të sportit, konsujt e nderit apo ndonjë personalitet i diasporës. Por asnjë prej këtyre funksioneve, që në fakt janë pjesë e punës sonë, nuk e zëvendëson rëndësinë dhe plotfuqishmërinë e ambasadorit të shtetit. Njohjet dhe kontaktet e politikanëve dhe qeveritarëve tanë me homologët e tyre në botë, bëjnë që ndonjëherë të neglizhohet apo të anashkalohet roli i ambasadorit në axhendën e autoriteteve tona, por kjo nuk e zbeh dhe nuk mund të zgjasë shumë, pasi axhenda dhe kujtesa e ambasadës është e vetmja që ka plotfuqishmëri dhe jetëgjatësi.

(Traduzione in italiano) Ulteriori Riflessioni dell'Autore

50 anni di relazioni estere è un libro dell'ambasciatore Dashnor Dervishi. Il libro è scritto sulla base degli appunti tenuti durante l'attività diplomatica estera, delle informazioni ufficiali e delle analisi redatte per il MAE albanese nella carica di ambasciatore, nonché delle sue memorie e delle impressioni personali del tempo.

Dei 50 anni di servizio nelle relazioni estere, i primi 20 anni che vengono trattati in questo libro, che appartengono al periodo fino al 1992, sono suddivisi in più fasi temporali. Secondo i capitoli, le note sono accompagnate da fotografie e documenti originali dell'epoca. Le vicende e le riflessioni che emergono dalla pubblicazione della prima parte, mettono

in luce che nonostante il sistema sociale e gli interessi della classe politica dirigente, i principi fondamentali degli interessi strategici del Paese rimangono sempre gli stessi nelle fondamenta della politica estera di ogni Paese.

